

Vendim nr. 106 datë 17.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 17.05.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 5 (N) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **NDRIÇIM STOJKU**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3297, datë 24.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokolli nr. 1 i saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ndriçim Stojku rezulton se ka punuar për një periudhë rreth 6 vjet e 4 muaj në detyrën e doganierit. Në momentin e lirimit nga shërbimi civil ai ka mbajtur detyrën e doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik në Zyrën e Operacioneve Doganore në Degën e Doganës Kakavijë (Gjirokastrë).

2. Gjatë një kontrolli të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në Degën e Doganës Kakavijë është konstatuar se disa nga doganierët e parkingut dhe pikës së hyrjes, ndër të cilët edhe kërkuesi, nuk kanë arkëtuar tarifën e parkingut dhe taksën e autobusëve me targa të huaja, duke shkelur Kodin Doganor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, pasi nuk kanë zbatuar legjislacionin në fuqi për mbledhjen e këtyre tarifave. Sipas këtij raportit të këtij kontrolli rezulton se kërkuesi nuk ka mbledhur tarifën e parkingut në shumën 202 mijë lekë dhe tarifën “*ditë qëndrimi për autobusët me targa të huaja*” në një shumë të konsiderueshme. Mosarkëtimi i këtyre tarifave shkakton dëm ekonomik të të ardhurave të shtetit. Ndaj këtij raporti kërkuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij me shkrim.

3. Bazuar në shkeljet e konstatuara nga raporti përfundimtar i KLSH-së, Dega e Doganës Kakavijë, me shkresën nr. 2114 prot., datë 11.11.2014 “Raportvlerësimi në bazë të raportit përfundimtar të KLSH-së...”, ka propozuar marrjen e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” të kërkuesit, mbështetur në nenin 59/2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

4. Mbi bazën e kësaj shkrese, në datën 11.12.2014 është mbledhur Komisioni Disiplinor, i cili, me vendimin nr. 27136/3, datë 11.12.2014, ka vendosur pezullimin nga detyra të kërkuesit derisa ky komision të shprehej me vendim përfundimtar. Kërkuesi është njoftuar më pas se në datën 16.12.2014 do të zhvillohej seanca dëgjimore nga Komisionit Disiplinor, ku do të shqyrtohej masa disiplinore e propozuar ndaj tij.

5. Në datën 16.12.2014 është mbledhur Komisioni Disiplinor, i cili, pasi ka dëgjuar relatinin e kryetarit të Degës së Doganës Kakavijë, në cilësinë e eprorit direkt të kërkuesit dhe pretendimet e parashtruara prej kërkuesit, me vendimin nr. 27136/6, datë 16.12.2014, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, pasi sipas Kodit Doganor dhe akteve në zbatim të tij ka rezultuar se kërkuesi nuk ka kryer detyrën funksionale në zbatim të “Rregullores së brendshme të degëve doganore” nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, si dhe shkresës nr. 16914/1 prot., datë 11.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të Doganave “*Mbi elementet e domosdoshme etike në shërbimin doganor*”.

6. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 27136/3, datë 11.12.2014 “Për pezullimin nga shërbimi civil” dhe vendimin nr. 27136/6, datë 16.12.2014 të Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave “Për largimin nga shërbimi civil”, duke kërkuar kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës

prej datës 11.12.2014 e në vazhdim, me pretendimin se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

7. Me vendimin nr. 1879 (80-2015-660), datë 09.04.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së ngritur nga kërkuuesi, duke shfuqizuar vendimin nr. 27136/ 3, datë 11.12.2014 “Për pezullimin nga shërbimi civil” dhe vendimin nr. 27136/ 6, datë 16.12.2014 të Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave “Për largimin nga shërbimi civil”. Po ashtu, kjo gjykatë ka vendosur edhe kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, doganier klasifikim/ vlerësim/ kontroll fizik, Zyra e Operacioneve Doganore në Degën e Doganës Kakavijë (Gjirokastrë), duke i paguar pagën e këtij pozicioni prej datës 11.12.2014 e në vazhdim. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur në këtë proces, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. duke pretenduar se vendimi për marrjen e masës disiplinore është marrë në përputhje me ligjin dhe kompetencat ligjore të Komisionit Disiplinor, i cili ka respektuar formën dhe procedurën e nxjerrjes së aktit.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1327 (147), datë 08.06.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1879 (80-2015-660), datë 09.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova e në ligj, duke arsyetuar se rezulton e provuar se kërkuuesi nuk ka përmbushur detyrat e tij funksionale në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore që rregullojnë fushën e doganave dhe se KLSH-ja ka evidentuar shkelje, të cilat kanë sjellë pasoja për buxhetin e shtetit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuuesi.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3297, datë 24.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuuesi ndaj vendimit nr. 1327 (147), datë 08.06.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

10. Në datën 24.03.2023 kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3297, datë 24.11.2022 të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuessit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar ka cenuar:

11.1. *Parimin e barazisë dhe proporcionalitetit*, pasi procedimi disiplinor i ndjekur nga komisioni disiplinor ka qenë i kundërligjshëm, pasi nuk ka respektuar legjislacionin përkatës. Shkeljet procedurale nga ana e Komisionit Disiplinor kanë qenë jokoherente dhe nuk kanë respektuar procesin e rregullt ligjor. Në raste analoge për shkelje të tilla të raportuara nga KLSH-ja, komisioni nuk ka disponuar me lirim nga shërbimi civil.

11.2. *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial*, pasi Gjykata e Lartë nuk duhej të vendoste mospranimin e rekursit pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuarit, për më tepër kur dy gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të kundërta. Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar funksionin e saj subsidiar, duke i kufizuar kërkuarit të drejtën e aksesit. Vendimi i saj është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush standardin e arsytimit, si dhe krijon paqartësi, duke mos dhënë qoftë edhe në një argument për pretendimet me natyrë kushtetuese, çka do ta bënte jo vetëm të kuptueshëm qëndrimin e saj, por do të përlligjte edhe vendimmarrjen e kësaj gjykate.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin konkret kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar. Duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 24.11.2022 që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor që ka vendosur largimin nga shërbimi civil të kërkuesit, ai ka përmbushur edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në dispozicion. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues është paraqitur në datën 24.03.2023, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, megjithëse ai kishte ngritur pretendimin e cenimit të parimit të barazisë dhe proporcionalitetit, pasi procedimi disiplinor i ndjekur nga komisioni disiplinor ka qenë i kundërligjshëm, pasi nuk ka respektuar legjislacionin përkatës. Shkeljet procedurale nga ana e komisionit disiplinor kanë qenë jokoherente dhe nuk kanë respektuar procesin e rregullt ligjor. Në raste analoge, për shkelje të tilla të raportuara nga KLSH-ja, komisioni nuk ka disponuar me lirim nga shërbimi civil.

15. Në kuptim të sa më sipër, procedurat administrative që zhvillohen nga komisioni disiplinor për largimin nga shërbimi civil zhvillohen në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative që për shkelje shumë të rëndë dhe që sjell pasoja aplikohet masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil. Gjatë këtij procesi komisioni disiplinor zhvillon një proces administrativ, i cili ka parimet e veta që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e provave konkrete që i shërbejnë për të marrë vendimet përkatëse. Ky proces duhet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil (*neni 41 i ligjit nr. 152/2013*). Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar (*neni 59*).

16. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në nivel kushtetues se në cilin aspekt të parimit të barazisë dhe proporcionalitetit është cenuar nga vendimi i komisionit disiplinor, kurse për sa u përket argumenteve të tij se komisioni disiplinor në

raste të tjera mund të mos ketë marrë masën disiplinore të shkarkimit apo që në rastin e tij duhej të kishte marrë masë më pak të ashpër, Kolegji vlerëson se janë të pamjaftueshme dhe lidhen thelbësisht me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit në çështjet konkrete, si dhe vlerësimin e fakteve dhe rrethanave, të cilat janë çështje që nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, nëse nuk provohet se kanë cenuar të drejtat kushtetuese të individit.

17. Pretendimet e tjera të kërkuarit për cenimin e procesit të rregullt ligjor lidhen në thelb me arsyetimin e bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në këtë këndvështrim, nisur nga thelbi i këtyre pretendimeve, vërehet se ato *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe do të analizohen në vijim në drejtim të standardit të arsyetimit të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të ankimit në kuptimin substancial.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial

18. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk duhet të vendoste mospranimin e rekursit pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të të kërkuarit, për më tepër kur dy gjykatat më të ulta kanë mbajtur qëndrime të kundërta. Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar funksionin e saj subsidiar, duke i kufizuar kërkuarit të drejtën e aksesit. Vendimi i saj krijon paqartësi duke mos dhënë qoftë edhe një argument për pretendimet me natyrë kushtetuese, çka do ta bënte të kuptueshme qëndrimin, por do të përligjte edhe vendimmarrjen e kësaj gjykate.

19. Në jurisprudencën kushtetuese për procesin e rregullt, Gjykata është shprehur se disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e standardeve të tjera (*shih vendimin nr. 5, datë 09.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si garanci për të drejtën e procesit të rregullt ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie

ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me rastet e vendimeve diametralisht të kundërta të dhëna nga gjykatat më të ulëta, jurisprudenca kushtetuese është shprehur se në këto raste Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka një rol të pazëvendësueshëm, nën dritën e të drejtave të aksesit dhe të ankimit në kuptimin substancial, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 62, datë 23.09.2015; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për shkak të këtij roli, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Në të tilla raste kërkuesit, nëse nuk merr përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr.4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit*, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006; nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu rikthyer rastit konkret, vërehet se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur nga kërkuesi. Ndër të tjera, në rekurs kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka zbatuar gabim ligjin material dhe nuk ka arsyetuar nëse kërkuesi ka vepruar në kundërshtim me detyrat funksionale të tij, që ka çuar në largimin e padrejtë të tij nga shërbimi civil.

22. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Kjo dispozitë para datës 05.05.2017 parashikonte se vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit dhe gjykata administrative e shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi është dhënë në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kur ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjyimit, si dhe kur ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Në këtë rast, sipas këtij kolegji, nuk ngrihen problematika në rekurs që bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material apo procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe nga rekursuesi nuk është parashtruar asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale përpara kësaj Gjykate. Sipas Kolegjit Administrativ, në rastin objekt gjykimi pretendimet e ngritura në rekurs janë çështje të vlerësimit të provave, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë dhe nëpërmjet rekursit dhe gjyimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet edhe një herë rishqyrtimi gjyqësor i provave. Për këtë fazë të gjyimit shqyrtimi gjyqësor është i mbyllur dhe prekluzohet pas shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit (*shih paragrafët 10-11 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Për këto arsye, në përfundim të gjyimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

23. Lidhur me pretendimin e kërkuarit se Gjykata e Lartë nuk duhej të vendoste mospranimin e rekursit pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuarit, për më tepër kur dy gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të kundërta, Kolegji thekson se vetëm fakti se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari edhe pse kishte dy vendime diametralisht të kundërta të dy gjykatave më të ulëta, nuk mjafton për të vënë në dyshim të drejtën e kërkuarit për proces të rregullt ligjor. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese, në këto lloj rastesh merr rëndësi përcaktuese natyra kushtetuese e pretendimeve që kërkuarit kanë ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Vetëm kur pretendimet në rekurs synojnë verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjyimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit*, duhet të ushtrojë funksionin e saj për zgjidhjen e

mosmarrëveshjes gjyqësore dhe t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs.

24. Në këtë pikëpamje, Kolegji, duke iu kthyer çështjes konkrete, vëren se pretendimet e kërkuarit në rekurs janë me natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, si dhe me interpretimin e ligjit procedural për fuqinë dhe vlerën e provave, si dhe zbatimin e keq të ligjit material. Kolegji i Gjykatës së Lartë, duke proceduar në dhomë këshillimi, i ka verifikuar ato në funksion të aksesit në gjykatë dhe ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se shkaqet e paraqitura janë haptazi të pambështetura në ligj.

25. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e kolegjit në vështrim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 për natyrën e këtyre shkaqeve.

26. Gjithashtu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke iu dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs nga kërkuari, në përputhje me detyrimin ligjor, sipas nenit 473/a, pika 1, të KPC-së, i ka garantuar atij të drejtën e aksesit në drejtim të së drejtës së ankimit substancial në një gjykatë më të lartë. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit substancial, janë të pabazuara.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.